



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 1174 / prot.
3

Tiranë më 27.9.2018

Lënda: Dërgojmë mendim mbi “*Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kroacisë mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë së kufijve*”.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.5875/3 Prot., datë 18.09.2018, me anë të së cilës kërkohet mendim mbi “*Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kroacisë mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë së kufijve*”, Zyra e Komisionerit vijon t’i mbetet mendimit të dhënë më parë, me shkresën nr.1174/1 prot., datë 18.07.2018, të cilën nuk e gjejmë të reflektuar në këtë memorandum dhe e dërgojmë sërish duke sugjeruar si vijon:

Me qëllim përshtatjen me terminologjinë e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, sugjerojmë që në nenin 2, të memorandumit, përkufizimi i termave, “*Të dhëna personale*” të jetë i plotë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në kuadër të transpozimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR-së) dhe Direktivës së Policisë 2016/680 në legjislacionet respektive të dy vendeve, si dhe ndryshimeve të mundshme që mund të ndodhin e që nuk janë të parashikuara në Marrëveshjen “*Mbi bashkëpunimin Policor*”, sugjerojmë që në fund të nenit 13, të projekt marrëveshjes, të shtohet togfjalëshi “*...dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale*”. Gjithashtu në këtë nen, të memorandumit, togfjalëshi “*...Kapitulli V*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*...Kreu VI*”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

